



VENDIM

Nr. 124, Datë 14.10.2015

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “ C & S ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.03.2009 të Bordit të komisionerëve të ERE, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie;

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9, pika 4./10 gërma “c”). Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “C & S Energy” sh.p.k. nuk ka realizuar kontrata të mëparshme.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj ISSH),
- Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar (neni 9, pika 4/10, germa “a”) dhe
- Kapitalin financiar të deklaruar nga shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti, (neni 9, pika 4/10 gërma “b”),

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për liçensimin shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI